

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësi Org. Org. Unit: 06/40/	Nr. Prot. Prot. No.: 1151-1/2021
Nr. i Tësorës Broj Stranica No. pages: 1	Data Datum Date: 30/07/2021
Dofesa PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Departament - Budzet Departament

DATË	27.07.2021
REFERENCË	n/v. 178/2021
PËR/ZA/TO:	z. Rexhep Bllaca, Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)
CC	znj. Rozeta Hajdari, Ministre, MINT z. Irfan Lipovica, zv. Sekretar i Përgjithshëm, MINT
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, MFPT
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, MFPT
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinioni i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese

I nderuari z. Bllaca,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese, formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Departamenti i Buxhetit paraqet:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese përcakton kërkesat, masat dhe procedurat për mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuese dhe të drejtave që rrjedhin nga ky projektligj. Ky projektligj zbatohet nga persona fizikë dhe juridikë që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit për mbrojtjen e

topografive të produktve gjysmëpërçuese në Agjencinë për Pronësi Industriale në Republikën e Kosovës.

OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor për projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese dhe e ka paraqitur në formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor. Sipas vlerësimeve të MINT-së, ky projektligj ka kosto totale €15,704 për vitet 2021-2023, kosto kjo e cila e shpërndarë nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve është si në vijim:

Kategoria e shpenzimeve	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Totali
Nr. Punëtorëve	11	11	11	11
Paga dhe Shtesa	€2,020	€4,041	€4,042	€10,103
Mallra dhe Shërbime	€1,020	€2,291	€2,291	€5,601
Totali	€3,040	€6,332	€6,333	€15,704

Kostimi përfshinë 11 zyrtarë aktualë të Agjencisë për Pronësi Industriale me angazhim në 5% të kohës së tyre për zbatimin e aktiviteteve që derivojnë nga ky projektligj e që kanë të bëjnë me: hartimin e akteve nënligjore, trajnimin e zyrtarëve në fushën e topografisë së qarqeve të integruara, zhvillimin e procedurave për regjistrimin e topografive, shqyrtimin e ankesave, etj. Në vitin 2021, është përlogaritur kosto për gjysmën e vitit (muajt korrik-dhjetor).

Përfundim:

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve vlerëson se Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese ka kosto totale në vlerë prej €15,704 për vitet 2021-2023. Zbatimi i këtij projektligji nuk krijon kosto shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe vlerësimeve për vitet 2022 dhe 2023, kjo kosto është brenda ndarjeve buxhetore të Agjencisë për Pronësi Industriale në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Përgatitur nga: Zana Radoniqi, Analiste e Lartë e Buxhetit

Konfirmoi: Milaim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet Qendror

